ENTI RREGULLATOR I UJIT

# AMORTIZIMI I ASETEVE SI KOSTO E JUSTIFIKUAR PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE UJËSJELLËS KANALIZIME

Ndriçim SHANI
Kryetar i ERRU-së

Tiranë
Nëntor 2023

# Misioni i ERRU-së dhe Metodologjia e Tarifave

## MISIONI:

- ***Mbrojtja e Konsumatorëve nga abuzimi i mundshëm i shoqërive UK me tarifa të larta të pajustifikuara ndaj tyre.***
- ***Nxitja e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK .***

## KRITERET E METODOLOGJISË

- ***Mbulimi i Kostove të justifikuara të O&M (OPEX), ose Kostove Totale (OPEX + CAPEX + RAB x WACC )***
- ***Vlerësimi i Performancës*** së shoqërisë nëpërmjet TKP.
- ***Përballueshmëria*** e faturës së shërbimeve UK nën kufirin 5% të shpenzimeve/ardhurave mesatare mujore për familje.
- ***Mbrojtja e Mjedisit*** për ruajtjen e burimeve ujore nga mbipërdorimi duke dekurajuar mbikonsumin me anë të aplikimit të tarifave me blloqe.

# Metodologjia “Cmimi Tavan”, Kostot e Pranuara

## Kostot OPEX ose të O&M (të pranuara)

- *Materialet* – kimikatet, *energjia elektrike,* karburantet, materiale pune operative, zyre, etj.
- *Shërbime nga jashtë* – sigurime, qira, shërbime postare, konsulenca, ruajtja e objekteve, riparime me të tretët etj.
- *Pagat – pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore*.
- *Taksat* – Tatime dhe taksa, pagesa rregullatore, etj.
- *Kosto të tjera* – shpenzime udhëtimi, gjyqësore, dieta ushqimore etj.

## Kostot CAPEX ose Kapitale (të pranuara)

- *Amortizimi i aseteve të trupëzuara ekzistuese,* të aseteve në proçes zbatimi edhe atyre të planifikuara në të ardhmen sipas PB 5 Vjeçar.
- *Pagesa e principalit të huave për investime*.

## Kostot RAB x WACC të fitimit ose të Kthimit në Kapitale

# Amortizimi si Kosto e CAPEX

**Zëri i amortizimit si kosto i CAPEX reflektohet në PB 5 Vjeçar, përkatësisht:**

I. **Amortizimi i aseteve të trupëzuara (ekzistuese dhe të inventarizuara në regjistrat e shoqërisë) që ka lidhje me vjetërsimin e aseteve.**

II. **Amortizimi i aseteve të projekteve/investimeve akoma në proçes zbatimi (të pa inventarizuara nga shoqëria).**

III. **Amortizimi i aseteve të investimeve të planifikuara gjatë periudhës së Planit të Biznesit 5 Vjeçar (të pa inventarizuara nga shoqëria).**

# Amortizimi si Kosto e CAPEX

*Amortizimi, si një zë i konsiderueshëm i kostove të pranuara në përcaktimin e nevojës për të ardhura, kërkon një analizë të kujdesshme të kostove të tij nga ana e ERRU-së*

## Qëllimi :

**Menjanimi i rasteve të abuzimit me këtë zë të kostove nga shoqëritë UK për të përftuar artificialisht tarifa të larta të shërbimeve UK, përkatësisht :**

- **Duke i mbivlerësuar kostot e amortizimit nga ato faktike**
- **Duke mos respektuar normat e jetëgjatësisë së dobishme të përcaktuara nga ERRU.**
- **Duke përdorur fondet e amortizimit për qëllime të tjera në vend të dedikimit të tyre për zëvendësimit të aseteve.**

# Amortizimi i Aseteve të Sistemeve UK

**Amortizimi i aseteve të projekteve/investimeve akoma në proçes zbatimi duhet të mbështetet në dokumentacionin e projekteve të tyre.**

**Amortizimi i aseteve të investimeve të planifikuara gjatë periudhës së Planit të Biznesit 5 Vjeçar, pjesa e së cilës (referuar edhe strategjisë TTT) parashikohet të financohet nga tarifat e propozuara në aplikim, referuar Nenit 33, pika 4 të metodologjisë së tarifave duhet që :**

➡ ***Shoqëria të justifikoje e vërtetojë nevojën e investimeve të parashikuara me dokumente ligjore, efikasitetin për optimizimin e kostove, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve të rregulluara dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e treguesve kryesore të performancës.***

# Amortizimi dhe Plani Menaxhimit të Aseteve

- **Amortizimi për asetet e trupëzuara që duhen zëvendësuar është i domosdoshëm për të eliminuar fenomenin e vjetërsimit të aseteve.**
- **Vjetërsimi i aseteve përtej jetëgjatësisë së dobishme vjen nga mos planifikimi i fondit të amortizimit për zëvendësimin e tyre duke përkeqësuar TKPs dhe rrezikuar sigurinë e shëndetit publik.**
- **Kostot e Amortizimit (sidomos për tubacionet) duhet të jenë pjesë e kostove të tarifave të reja të propozuara nga shoqëritë UK.**
- **Në sektorin me 58 shoqëri UK, 46 prej tyre nuk mbulonin kostot e O&M, pra nuk mund të planifikonin zëvendësim të aseteve.**
- **Mbas rajonalizimit disa SPK arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot e O&M, pra me tarifat e propozuara të mbulojnë edhe amortizimin e aseteve.**
- ***Amortizimi për asetet e trupëzuara duhet ti referohet dhe të zbatohet ne përputhje me Planin e Menaxhimit të Aseteve të shoqërisë.***

# Amortizimi dhe Plani Menaxhimit të Aseteve

- Plani i Manaxhimit të Aseteve (PMA) është një plan taktik për menaxhimin e infrastrukturës dhe të aseteve të tjera për të ofruar një standart shërbimi të caktuar.
- PMA është i nevojshëm raportimin financiar, mirëmbajtjen dhe zv e aseteve
- PMA ka si bazë inventarin e aseteve me programe kompjuterike që realizohet me anë të GIS ku të dhënat regjistrohen, menaxhohen dhe analizohen në mënyrë gjeografike në terren plus tabela të dhënash për objektet, si përmasa, materiali, koha e instalimit, vlera, etj.

Disa nga përfitimet e menaxhimit të aseteve, janë :

- ➢ planifikim dhe financim për zëvendësime në të ardhmen;
- ➢ njohuri më të sakta mbi vendodhjen e aseteve;
- ➢ O&M më efikase e tarifa të bazuara mbi informacion të saktë të O&M;
- ➢ pranueshmëri e argumentuar për rritjen e tarifave
- ➢ projekte për përmirësime kapitale.

# Amortizimi në Sektorin UK

## Normat e Jetëgjatësisë së Dobishme (amortizimi) të Aseteve Materiale në Sistemet e FU dhe KUN (aprovuar nga ERRU në metodologjinë e tarifave)

| Nr. | Llojet e Aseteve | Jetëgjatësia e Dobishme (vite) | | Norma Vjetore e Amortizimit (%) | | Diferenca ne Jetëgjatësi (vite) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2021 | 2022 | 2021 | 2022 | 2022-2021 |
| 1 | Burimet e ujit | 20 | 50 | 2% | 5% | +30 |
| 2 | Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet | 20 | 50 | 2% | 5% | +30 |
| 3 | Rrjeti i tubacioneve për FU dhe KUN. | 20 | 50 | 2% | 5% | +30 |
| 4 | Aksesoret, si saraçineska, ajrues, puseta. | 5 | 10 | 10% | 20% | +5 |
| 5 | Makineri, pajisje prodhimi dhe shërbimi | 5 | 10 | 10% | 20% | +5 |
| 6 | Matësa | 7 | 7 | 14% | 14% | - |
| 7 | Automjete transporti | 5 | 10 | 10% | 50% | +5 |
| 8 | IT, pajisjet kompjuterike, produktet software etj. | 4 | 5 | 20% | 25% | +1 |

# Amortizimi – Eksperienca Ndërkombëtare

## Normat e Jetëgjatësisë së Dobishme të Aseteve Materiale në Sistemet e FU dhe KUN

| Nr. | Llojet e Aseteve | Jetëgjatësia e Dobishme (ne vite) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shqipëri | Itali | Irlande | Belgjike Flanders | Portugali | Lituani |
| | | Reference viti 2022 | | | | | |
| 1 | Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet | 50 | 40 | 55 | 40 | 50 | 50-70 |
| 2 | Rrjeti i tubacioneve për FU dhe KUN. | 50 | 40 | 100 | 50 | 50 | 50 |
| 3 | saraçineska, ajrues, puseta. | 10 | 10 | 15 | 15 | 10 | 10 |
| 4 | Makineri, pajisje prodhimi dhe shërbimi | 10 | 20 | 25 | 15 | 10 | 10 |
| 5 | Matësa | 7 | 10 | 15 | 10-15 | 7 | 6 |
| 6 | Automjete transporti | 10 | 5 | 10 | 7-10 | 10 | 10 |
| 7 | IT, kompjutera, software. | 5 | 5 | 10 | 5 | 5 | 4 |

# Amortizimi në Sektorin UK

## Kostot e Amortizimit për Disa Shoqëri UK për Vitin 2021 dhe 2022

| | Shoqëritë UK (jo rajonale) | Kostot O&M (OPEX) viti 2021 | Kosto Totale (OPEX + CAPEX) viti 2021 | Amortizimi viti 2021 | Amortizimi ndaj KT viti 2021 | Amortizimi ndaj KT Viti 2022* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (në 000/lekë) | (në 000/lekë) | (në 000/lekë) | në % | në % |
| 1 | Vlorë | 637,343 | 873,033 | 234,658 | 27% | 24% ↓ |
| 2 | Shkodër | 367,530 | 647,981 | 255,745 | 39% | 36% ↓ |
| 3 | Korcë | 208,495 | 431,463 | 154,162 | 36% | 33% ↓ |
| 4 | Berat-Kuçovë | 177,049 | 274,511 | 96,846 | 35% | 33% ↓ |
| 5 | Kamëz | 334,377 | 801,660 | 415,45 | 52% | 51% ↓ |
| 6 | Sarandë | 204,861 | 305,805 | 85,859 | 28% | 24% ↓ |
| 7 | Pogradec | 152,787 | 319,302 | 129,793 | 41% | 35% ↓ |
| 8 | Lezhë | 146,766 | 360,107 | 204,569 | 57% | 49% ↓ |

* *Amortizimi për vitin 2022 duket në përqindje me i ulët krahasuar me vitin 2021 për shkak të rritjes së konsiderueshme të peshës së kostove të energjisë në kostot e O&M.*

# Amortizimi si Kosto të Justifikuara

***Te dhënat tregojnë se në përgjithësi Kostot e Amortizimit kanë vlera të konsiderueshme dhe influencojnë dukshëm në tarifat e shërbimeve UK.***

**ERRU duke respektuar kriterin e kostove të justifikuara, verifikon :**

- **A janë planifikuar (llogaritur) saktë, pra bazuar në inventarin e aseteve dhe në normat e jetëgjatësisë së dobishme vjetore të aprovuara të amortizimit ?**
- **A ka një ndarje të qartë të vlerës së amortizimit të aseteve të trupëzuara në inventar dhe atyre në proçes zbatimi, si dhe për ato që parashikohen në PB 5 Vjeçar (të pa inventarizuara) ?**

# Amortizimi si Kosto të Justifikuara

(vazhdim)

- A ka dhe janë respektuar prioritetet e zëvendësimit të aseteve bazuar në PMA që duhet të disponojë shoqëria UK?
- A janë përdorur në të kaluarën fondet e amortizimit në destinacionin e duhur, pra për zëvendësimin e aseteve ?
- Kur mungon PMA, në kostot e justifikuara ERRU mund ta marrë në konsideratë jo të plotë fondin e propozuar të amortizimit të aseteve gjatë proçesit të miratimit të tarifave.
- Në aplikimin e radhës për tarifa të reja ERRU do të pranojë vetëm pjesën e kostove të amortizimit që vërtetohet që janë përdorur për këtë qëllim.

# Thellimi më Tej në Kostot e Justifikuara

***Hapat e mëtejshme për përmirësimin e procesit të vlerësimit në të kostove të justifikuara në përgjithësi dhe për zëra të tjerë të kostove:***

- **Shoqëritë UK duhet të krijojnë, mbajnë dhe raportojnë të dhëna gjithnjë e më të sakta e të verifikueshme.**

- **ERRU për një analizë më të plotë të kostove të justifikuara kërkon në të ardhmen nga shoqëritë UK me shumë detaje dhe informacion për të gjithë elementet e veçanta të kostove të OPEX, pra të O&M, *në veçanti të Kostove të Punës*, si dhe për kostot e CAPEX në lidhje me *eficensën e investimeve të zbatuara*.**

# *Faleminderit për Vëmendjen !*

**ndricim.shani@erru.al**

**Cel. 069 20 30 920**

**Web: www.erru.al**

# Gj

- **Në krahasim me ujin e pijshëm sektori konsiderohet si dytësor**

# Metodologjia e tarifave dhe Amortizimi

**Në metodologjinë aktuale të miratimit të tarifave, përdoret metoda e "Çmimit Tavan" ku parashikohet edhe mbulimi i Kostove Totale bazuar në një Plan Biznesi 5 Vjeçar.**

**Tarifat llogariten bazuar në të ardhurat e nevojshme (NA) sipas formulës:**

$$NA = OPEX + CAPEX + RAB \times WACC$$

**Ku:**

**OPEX – Kostot e O&M;**

**CAPEX – Kostot Kapitale;**

**RAB – Baza e Aseteve të Rregulluara;**

**WACC – Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit.**